



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE

Projekt – Vendim

Nr 09 Dt 10.12 2025

“Për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë me nr 1460 prot, datë 16.03.2022, lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe shoqërisë AlbTelecom sh.a), (sot “ONE Albania sh.a”), për sipërfaqen prej 150 m2, pjesë e pasurisë nr 663, Zk nr 2708, e llojit “Truall”, në fshatin Mnelë, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: “Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë “ONE Albania sh.a”.

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, neni 27 pika 5, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.01.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, kontratës ekzistuese nr 1460 prot, datë 16.03.2022, VKM nr 10, datë 07.01.2005, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Vig Mnelë të qarkut të Shkodrës”, si dhe në certifikatën e pronësisë nr 2045946, lëshuar me datë 28.04.2020, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës të:

VENDOSI :

1. Miratimin e rinovimit të Kontratës së Qirasë nr 1460 prot, datë 16.03.2022, me afat 1 vjeçar, “Dhënie në përdorim të pasurisë së llojit “TRUALL”, me sipërfaqe prej 150 m2, “Për vendosjen e antenave dhe paisjeve të tjera ndihmëse, në ushtrimin e veprimtarisë së telefonisë celulare të shoqërisë “ONE Albania sh.a”, pjesë e pasurisë nr 663, ZK. nr 2708, fshati Mnelë, NJAD Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës.
2. Efektet: Sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera e qirasë vjetore të jetë 324 000 lekë/vit, (e njëjtë me kontratën paraardhëse).

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Konceptoi: N.Baqli

Miratoi: M.Deda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETIVE

RELACION

Mbi rinovimin e kontratës së qirasë nr 1460, datë 16.03.2022, "Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë "One Albania Sh.a"

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i Aseteve publike në territorin e Bashkisë është një ndër funksionet e Bashkisë. Bazuar në Ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë miratimi i dhënies në përdorim të tretëve sipas legjislacionit në fuqi, për pasuritë shtetërore në pronësi apo administrim të Bashkisë. Kontrata me nr 1460, datë 16.03.2022, ka patur për objekt vendosjen e antenave për ushtrimin e aktivitetit të telefonisë celulare të kompanisë "AlbTelecom sh.a". Me bashkimin e kompanive AlbTelecom (ish Eagle), dhe ONE (ish AMC), është krijuar subjekti i ri me siglen "Shoqëria ONE Albania sh.a", e cila i ka bërë kërkesë zyrtare Bashkisë për rinovimin e kontratës sipërcituar. Kontrata ka për objekt dhënien në përdorim të një sipërfaqe prej 150 m2, e llojit "Truall", në fshatin Mnelë, Nj Ad Vig Mnelë, "Për ushtrimin e aktivitetit të antenave të telefonisë celulare të shoqërisë "ONE Albania sh.a". Bazuar tek të dhënat periodike që na vijnë nga sektori i të Ardhuave pranë Bashkisë, rezulton se kjo kompani ka qenë korrekte vazhdimisht në përmbushjen e detyrimeve të saj kontraktore ndaj Bashkisë. Për rrjedhojë në plotësim të kërkesës tyre po ju paraqesim për miratim këtë Projekt Vendim. Rinovimi i kontratës do bëhet me të njëjtat kushte dhe afate me kontratën paraardhëse. **Kohëzgjatja 1 (një) vit, dhe vlera e qirasë do jetë = 324 000 lekë/vit.**

Duke ju falenderuar, ju ftojme të miratoni Projekt Vendimin e paraqitur.

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Hartuesit e Relacionit

N. Baqli

E.Preka

M.Deda

REPUBLIKA E SHQIPËRI
Ministria e Punëve
Të Bredhura



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

2045946

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 2708
Numri i Pasurisë 663 Volumi 3 Faqe 163
Adresa e Pasurisë MNELE E VOGËL
Lloji i Pasurisë TRUALL
Sipërfaqja Totale 29180.00 m2
Nga kjo : Sa Truall 29,180.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 250.00
Nqs pallat: Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BASHKIA	VAU DEJËS		1/1	VAU-DEJES

- pasurisë me numër 663
- është pronar i _____
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 2/4/2020 Nr. 5381

Data e lëshimit të çertifikatës
28/4/2020

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
ILIR DIBRA



HARTE TREGUESE E RREGJISTRIMIT

(Fragment)

AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS

DREJTORIA VENDORE
SHKODËR



Ing . Erjeta Ramaj

Erjeta Ramaj

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 2708

NUMRI I PASURISE: 663

VOL.

FAQE

INDEKSI I HARTES : K-34-76-(23-D) SHKALLA : 1

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER **Q/F: MNELE E**

B.KUFIZIMET

V. ----

L. 664

J. ----

P. ----

PRONARI

BASHKIA VAU DEJES

Siptr.-29180m2 nga kjo: S.nd.-250

Dt. 24.04.2020

2708

MNELE E VOGEL

663

664

664

AKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijn nga: Vol _____, Fq. _____

Quota Kadastrale: **2708** NR.i PASURISE: **663**

Vijon në: Vol _____, Fq. _____ deri në: Vol _____, Fq. _____ -->

Indeksi i Hartes: **k-34-76-(23-d)**

PERFUNDIMTARE (data): _____

Adresa e Pasurisë: Rrethi SHKODËR Q/F MNELE E VOGËL

Rr/L _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____

Përshkrim i veçantë:

SHKOLLA 8 VJEÇARE MNELE E VOGËL
VKM NR.10 DT.07.01.2005

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO , Ref: PL

RREGULL

UES

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtëst
1. <u>29,180.00</u> m ² Ref. <u>00000030</u>	1. <u>29,180.00</u> m ² Ref. <u>00000030</u>	1. <u>250.00</u> m ² Ref. <u>00000030</u>
2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____
3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____
4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____

Per pjesen e përbashkët :

PALLAT

Kuota e pjesmarrjes:

%

Nr i Pasurise (pallat):

Vol _____ Page. _____

C - SEKSIONI I PRONESISE

[illegible]

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00000030	14/04/2020	15_AV	NË PËRGJEGJËSI DHE ADMINISTRIM NGA MINISTRIA E ARSIMIT, DREJTORIA ARSIMORE SHKODËR	28/04/2020 12:00:		

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00000030	28/04/2020	15_AV				

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (SHKODËR)
Adresa: Lagjia Qemal Stafa, Prapa Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkoder**

SHKODËR, m28 4 2020
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol 3, Faqe 163, Zona Kadastrale 2708, Qyteti Shkoder

REGJISTRUESI


ILIR DIBRA

Florian Zija



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri
Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al
Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |
NIPT: J61814094W



Nr. 368/ Prot.

Tiranë më 04/11/2025

Lënda: Rikujtesë për rinovimin e kontratës – Nr. 1460 Prot., datë 16.03.2022 (Kod teknik: Mnela e Madhe 1348, ish-SH1008).

Drejtuar: Bashkia Vau Dejës

Të nderuar,

Në emër të shoqërisë "One Albania" sh.a., ju drejtohem sërish me këtë shkresë për të rikujtuar rëndësinë e rinovimit të kontratës së sipërcituar, e cila deri në këtë moment nuk është rinovuar.

Për shkak të mosrinovimit të kontratës, Bashkia Vau Dejës nuk ka mundur të lëshojë faturat për periudhën përkatëse, gjë që ka penguar edhe ne në përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj jush, pasi mungesa e kontratës aktive nuk mundëson realizimin e transaksioneve përkatëse.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, ju lutemi të merrni masat e nevojshme për rinovimin e kontratës në një afat sa më të shpejtë, në mënyrë që të mund të normalizohet procesi i faturimit dhe pagesave ndërmjet palëve.


Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të konfirmimit tuaj për vijimin e procedurave të rinovimit.

Me respekt

Shoqëria ONE Albania SH. A

Zv. Drejtore e Përgjithshme

Irida BONATI



Drejtore e Grupit Teknik

